



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E AUDITIT

SHESHI "NËNË TEREZA" REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 250 166 FAX: +4 250166


Nr. 2785 / Prot.

3

Tiranë më: 14.10.2014

MIRATOHET

REKTORI
Dhori KULE



PROGRAMI VJETOR I AUDITIMIT
VITI 2015

| PËRSHKRIMI I OBJEKTIVIT QË DUHET TË REALIZOHET | Masat në zbatim të objektivit | Kuadri kohor | Treguesit konkrete për vlerësimin e realizimit të çdo mase | Personat e kontaktit për ndjekjen e programit |
|--|--------------------------------------|-----------------------------------|---|--|
| 1.-Mbyllja e dokumentacioneve të Auditimit 2-Akt-verifikimi i rekomandimeve të lëna | | Janar 2015 | | 1-Ilida Kamberi 2- Selam Mataj 3- Marsela Thanasi |
| <u>I.AUDITIME TË PËRGJITSHME</u> | | | | |
| 1- Fakulteti i Drejtësisë Periudha 01.01.2013- 31.12.2014 | Përgatitja e programit të auditimit | 11 Shkurt deri më 15 Prill 2015 | Përgatitja e akt verifikimeve procesverbaleve, projektreportit. Memorandumit dhe raportin final me rekomandimet | 1-Ilida Kamberi 2.- Selam Mataj 3- Marsela Thanasi |
| 2- Filiali Sarandë Periudha 01.01.2012 - 31.05.2014 | Përgatitja e programit të auditimit | 20 Prill deri më 14 Maj 2015 | Përgatitja e akt verifikimeve procesverbaleve, projektreportit. Memorandumit dhe raportin final me rekomandimet | 1-Ilida kamberi 2-Selam Mataj 3- Marsela Thanasi |
| 3- Filiali Kukës Periudha 01.01.2012 - 31.05.2014 | Përgatitja e programit të auditimit | 25 Maj deri më 12 Qershor 2015 | Përgatitja e akt verifikimeve procesverbaleve, projektreportit. Memorandumit dhe raportin final me rekomandimet | 1-Ilida kamberi 2-Selam Mataj 3-Marsela Thanasi |
| 4 - Fakulteti i Histori Filologjisë Periudha 01.01.2013 -31.05.2014 | Përgatitja e programit të auditimit | 22 Qershor deri më 31 Korrik 2015 | Përgatitja e akt verifikimeve procesverbaleve, projektreportit. Memorandumit dhe raportin final me rekomandimet | 1-Ilida kamberi 2-Selam Mataj 3-Marsela Thanasi |

| PËRSHKRIMI I OBJEKTIVIT QË DUHET TË REALIZOHET | Masat në zbatim të objektivit | Kuadri kohor | Treguesit konkrete për vlerësimin e realizimit të çdo mase | Personat e kontaktit për ndjekjen e programit |
|--|--------------------------------------|--------------------------------------|--|--|
| 5- Fakulteti i Ekonomisë Periudha 01.01.2013 - 31.05.2014 | Përgatitja e programit të auditimit | 07 Shtator deri më 06 Nëntor 2015 | Përgatitja e procesverbaleve, projektreportit. Memorandumit dhe raportin final me rekomandimet | 1.-Ilda Kamberi 2.- Selam Mataj 3- Marsela Thanasi |
| 6- Instituti i Fizikës Bërthamore Viti 2014 | Përgatitja e programit të auditimit | 23 Nëntor deri më 18. Dhjetor 2015 | Përgatitja e procesverbaleve, projektreportit. Memorandumit dhe raportin final me rekomandimet | 1.-Ilda Kamberi 2.- Selam Mataj 3- Marsela Thanasi |
| 7- Zbatimi i Rekomandimeve në Njësitë e varësise | Përgatitja e programit të auditimit | 28 Dhjetor deri më 15. Janar të 2016 | Përgatitja e Aktverifikimit | 1.-Ilda Kamberi 2.- Selam Mataj 3- Marsela Thanasi |

PLANI STRATEGJIK I OBJEKTEVE PËR TU AUDITUAR NGA NJAB
nga VITI 2015 deri në VITIN 2019

| Nr | Objekte për t'u audituar NJAB | nga | Fusha për t'u audituar | Niveli i vlerësimit të riskut (i ulët/i mesëm/i lartë) | Planifikuar për Auditim (4+1) | | | | |
|----|--|-----|---------------------------|--|-------------------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|
| | | | | | Viti planifikuar 2015 | Viti I planif+1 2016 | Viti I planif+2 2017 | Viti I planif+3 2018 | Viti I planif+4 2019 |
| a. | 1 | | 2 | 3 | 4.1 | 4.2 | 4.3 | 4.4 | 4.5 |
| 1 | Rektorati | | | I mesëm | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| 2 | Fakulteti i Ekonomisë | | | I mesëm | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| 3 | Fakulteti i Histori Filologjisë | | | I mesëm | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| 4 | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | | | I mesëm | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 5 | Fakulteti i Drejtësisë | | | I mesëm | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| 6 | Fakulteti i Shkencave Sociale | | | I mesëm | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 7 | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | | | I mesëm | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 8 | Instituti i Studimeve Europiane | | | I mesëm | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 9 | Instituti i FizikësBërthamore të Zbatuar | | | I mesëm | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| 10 | Filiali Sarandë | | | I mesëm | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 11 | Filiali Kukës | | | I mesëm | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 12 | | | | | | | | | |
| | SHUMA | | | | 7 | 4 | 5 | 4 | 5 |

Drejtuessi i NJAB Ilda KAMBERI



| |
|----|
| 14 |
| 15 |
| 16 |
| 17 |
| 18 |
| 19 |
| 20 |
| 21 |
| 22 |
| 23 |



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E AUDITIT**

**SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 250 166 FAX: +4 250166**

**RAPORTI VJETOR
PËR VEPRIMTARINË
E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
NË
UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Viti 2014

Punoi: Marsela Thanasi

Pranoi: Ilda Kamberi

Universiteti i Tiranës

PËRMBATJA E LËNDËS

| | |
|--|----|
| 1. Përmbledhje e analizës mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Universitetin e Tiranës, gjatë vitit 2014 | 3 |
| 2. Baza ligjore | 4 |
| 3. Organizimi..... | 5 |
| 3.1 Misioni i Auditimit të Brendshëm..... | 5 |
| 3.2 Organizimi i Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Tiranës..... | 6 |
| 4. Analiza e veprimtarisë së auditimit të brendshëm | 7 |
| 4.1 Analiza e programit të auditimit për vitin 2014 | 7 |
| 4.2 Analiza e misioneve të auditimit..... | 8 |
| 4.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre | 8 |
| 4.4 Gjetjet kryesore sipas sistemeve | 9 |
| 4.5 Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm | 9 |
| 5. Rekomandimet | 10 |
| 5.1 Rekomandimet e propozuara..... | 10 |
| 5.2 Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit..... | 10 |
| 6. Monitorimi i sistemit dhe sigurimi i cilësisë..... | 11 |
| 7. Analiza e kapaciteteve audituese..... | 11 |
| 7.1 Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB-së..... | 11 |
| 7.2 Kapacitetet audituese..... | 11 |
| 8. Konkluzione | 12 |
| 8.1 Konkluzione mbi problematikën e punës audituese..... | 12 |
| 8.2 Prioritetet për vitin e ardhshëm | 12 |

1. Përmbledhje e analizës mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Universitetin e Tiranës, gjatë vitit 2014

Raporti Vjetor mbi veprimtarinë audituese në Universitetin e Tiranës pasqyron rezultatet e arritura nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Tiranës, për vitin 2014. Aplikimi i funksioneve të auditimit të brendshëm mundëson parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e rasteve abuzive dhe keqmenaxhimit të burimeve financiare, duke u përdorur si instrument në duart e menaxherëve për rritjen e performancës në Universitetin e Tiranës. Në mënyrë të vazhdueshme, auditimi është një mekanizëm, i cili siguron Rektorin që fondet publike janë përdorur për qëllimin për të cilin ato janë alokuar dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Njësia e auditimit të brendshëm në UT është krijuar në zbatim të Ligjit Nr. 9720 datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Universitetin e Tiranës” të ndryshuar me ligjin Nr. 10318, datë 16.09.2010.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm të pasqyruara në raportet e auditimit janë detajuar e analizuar gjatë zhvillimit të këtij raporti, në të cilin përshkruhet struktura organizative dhe burimet e njësisë së auditimit të brendshëm në Universitetin e Tiranës; analiza e programeve të auditimit, për vitin 2014 dhe misioneve specifike; trajtimi i fushave me risk më të lartë dhe gjetjet kryesore sipas sistemeve; vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm brenda njësive kryesore të UT-së. Një vend të rëndësishëm në këtë raport zënë rekomandimet e propozuara dhe reagimi i menaxhimit lidhur me zbatimin e tyre.

Janë evaduar 13 misione auditimi kundrejt 16 misioneve të programuara. Ndërkohë që janë 3 misione auditimi në process evadimi. Mospërputhja e realizimit me planin vjetor lidhet me disa faktorë, ku përfshihen: kërkesat e Rektorit për auditime jashtë planifikimit vjetor, si rrjedhojë e rivlerësimit të riskut për fusha të veçanta, gjë që ka sjellë ndryshimin e fushave/subjekteve për t'u audituar.

Sistemet dhe fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar me nivel të lartë risku është sistemi i kontrollit të brendshëm, që shfaqet me mangësi në kuadrin procedural brenda vetë njësive të audituara, ndërsa sistemi i kontabilitetit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore shfaqen me risk të mesëm dhe të ulët. Sistemi i

prokurimeve shfaqet me risk për sa i përket njohjes së legjislacionit të prokurimit publik dhe zbatimit të tij.

Rritja e auditimeve në ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të dhëna, që lidhet me performancën e veprimtarisë audituese vlerësohet me rëndësi të vecantë.

Rekomandimet e dhëna për subjektet e audituara përgjithësisht janë pranuar dhe është kuptuar nga menaxherët synimi i rekomandimeve për përmirësimin e dobësive dhe mangësive të gjetura, si dhe për të parandaluar mundësinë e shkeljeve apo abuzimeve.

Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna ndaj subjekteve të audituara, gjatë vitit 2014 është në proces, gjatë muajit janar 2015. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve siguron informacion mbi vlefshmërinë dhe dobishmërinë e auditimeve. Ulja e numrit të shkeljeve të përsëritura dhe nivelit të riskut si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të auditimit është tregues i performancës së lartë të auditimeve dhe impaktit që vetë auditimi ka në aktivitetet e UT-së.

2. Baza ligjore

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është Ligji nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010. Ai përcakton rregullat kryesore për realizimin e procesit të auditimit të brendshëm për të garantuar kryerjen e auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare. Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Universitetin e Tiranës, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Akte të tjera nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 806, datë 6.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.139, datë 28.01.2007;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, dt.29.04.2012.
- Urdhëri i Ministrit të financave Nr. 69, datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik;

- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”;

Në kuadrin ndërkombëtar, Praktika Profesionale Ndërkombëtare, që përmban Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikën Profesionale të publikuara nga IIA përbëjnë bazën e paketës ndërkombëtare të zbatueshme për auditimin e brendshëm në Shqipëri.

Universiteti i Tiranës është institucion i arsimit të lartë kërkimor shkencor që funksionon në bazë të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, Statutit të Universitetit të Tiranës, miratuar më datë 16.12.2009, ndryshuar me Vendimet e Senatit Akademik nr. 10, datë 18.04.2012 dhe nr. 2, datë 13.02.2013, si dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendimin nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të UT-së, i ndryshuar.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Financave Nr. 69, datë 29.09.2010 pika 4 “Për miratimin e manualit të Auditimit të Brendshëm” për Universitetin e Tiranës”, është miratuar manuali specifik i Auditit të Brendshëm në Universitetin e Tiranës.

3. Organizimi

3.1 Misioni i Auditimit të Brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Këtë mision auditit i brendshëm në UT e realizon:

- a) Duke kryer vlerësime të pavarura të sistemeve të kontrollit dhe efijencës, bazuar në standartet profesionale të miratuara.
- b) Duke ndihmuar menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar.
- c) Duke mbështetur menaxhimin për arritjen e objektivave

Vlerat që karakterizojnë veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në UT janë integriteti, pavarësia, objektiviteti, ngritja e vazhdueshme profesionale, profesionalizmi, komunikimi dhe informimi.

Misioni i Auditit të Brendshëm në UT, lidhet me përgjegjshmërinë dhe përgjegjësitë për aplikimin e legjislacionit të ri për auditin e brendshëm, për zhvillimin dhe implementimin e metodologjive, bazuar në standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.

3.2 Organizimi i Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Tiranës

Struktura e Auditimit të Brendshëm bazohet në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kartën dhe Kodin e Etikës për audituesit. Njësia e Auditit të Brendshëm në Universitetin e Tiranës funksionon me 3 auditues të brendshëm, të cilët janë të certifikuar në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në njësitë publike”, si dhe VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në njësitë publike”.

Tab.4 Numri i AB në Universitetin e Tiranës

| EMERTIMI | NUMRI STRUKTURAR | PUNONJËS PLANIFIKUAR | PUNONJËS FAKTIK | TË CERTIFIKUAR | TË PA CERTIFIKUAR |
|--------------|------------------|----------------------|-----------------|----------------|-------------------|
| Drejtor | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Specialist | 2 | 2 | 2 | 2 | 0 |
| SHUMA | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 |

Drejtorja e Auditit të Brendshëm në Universitetin e Tiranës varet dhe raporton drejtpërdrejt tek Rektori, sa i përket përgjegjësive dhe linjave të raportimit.

Profesioni i audituesve në UT i përket fushës ekonomike, me ekperiencë profesionale mesatarisht mbi 20 vjet, kurse në fushën e auditimit mesatarisht 7 vjet. Eksperienca e gjatë në fushën e menaxhimit financiar ndihmon në realizimin me profesionalizëm të punës së audituesve brenda njësisë tonë.

4. Analiza e veprimtarisë së auditimit të brendshëm

4.1 Analiza e programit të auditimit për vitin 2014

Plani vjetor përcakton qartë objektivat për t'u arritur, treguesit e matjes së performacës së auditimit, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut. Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor 2014 të Auditimit të Brendshëm në UT është bërë duke zbatuar standardet në planin e punës për auditimin e brendshëm.

Për vitin 2014, krahasuar me vitin paraardhës vihet re rritje si në planifikimin e subjekteve për t'u audituar, ashtu dhe në numrin e angazhimeve të realizuara.

Janë evaduar 13 misione auditimi kundrejt 16 misioneve të programuara. Ndërkohë që janë 3 misione auditimi në process evadimi. Në mënyrë të përmbledhur, informacioni lidhur me realizimin e misioneve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Lloji i auditimit | Plani vjetor | Plani vjetor i rishikuar i auditimeve 2014 | Të evaduar | Në process evadimi |
|--------------------------------|--------------|--|------------|--------------------|
| Të plota | 5 | 5 | 3 | 2 |
| Të pjesshme | 8 | 11 | 10 | 1 |
| Gjithsej | 13 | 16 | 13 | 3 |
| Zbatimi i rekomandimeve | 9 | 9 | | 9 |

Realizimi i planit vjetor sipas llojeve të auditimit ka shmangie nga ai i planifikuar për këto arsye:

1. Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut. Për rrejdhojë ka pasur kërkesa nga titullari për kryerjen e auditimeve të rëndësisë së veçantë jashtë planifikimit.

2. Mbivendosja e misioneve të auditimit të parashikuara nga strukturat e auditimit të brendshëm në UT me auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit.

4.2 Analiza e misioneve të auditimit

Gjatë vitit 2014 janë kryer gjithsej 3 auditime të plota, konkretisht në Institutin e Studimeve Europiane, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Fakultetin e Shkencave Sociale. Misionet e plota të auditimit janë realizuar me bazë sistemi.

Bazuar në programin vjetor të auditimit, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014 ishte planifikuar auditim i plotë për filialet e Kukësit dhe Sarandës. Këto auditime nuk u realizuan, pasi me urdhër të Rektorit u vendos të fillonte auditimi tematik për kontrollin e projekteve kërkimeve shkencore në disa njësi përbërëse të UT-së.

Në misionet e realizuara janë konstatuar parregullsi që lidhen me moszbatimin me rigorozitet të legjislacionit mbi bursat e studimit, mbi dhënien me qera të ambienteve të fakulteteve, mos mbledhjen në kohë dhe rakordimin e të ardhurave nga tarifat e shkollimit, si dhe moszbatimin rigoroz të procedurës në fushën e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

4.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Në Planin Strategjik dhe Vjetor të NJAB-së janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e UT-së. Vlerësimi i riskut është bërë sipas metodologjisë përkatëse. Përcaktimi i nivelit të riskut është bërë duke marrë në konsideratë:

- Materialitetin sipas volumit – transaksionet me volum të madh që i përkasin pagesave të tarifave shkollore për numrin e madh të studentëve që shkollohen në Universitetin e Tiranës;
- Mungesën e rregulloreve specifike për fusha të ndryshme, të nevojshme në fillimin e vitit akademik;
- Mjedisi i kontrollit të brendshëm;

Fusha me risk të lartë në njësitë përbërëse të UT, të planifikuara në fillim të vitit 2014 nuk janë identifikuar. Por gjatë auditimit në Institutin e Studimeve Europiane u konstatua me risk të lartë sistemi i kontrollit të brendshëm. Për zvogëlimin e riskut në këtë njësi u lanë një sërë rekomandimesh, të cilat u morën në konsideratë nga drejtuesi i njësisë së audituar dhe Rektori.

Fushat me risk më të mesëm janë konsideruar: mbledhja e tarifave të shkollimit, procedura e pagesës dhe zbatimi i legjislacionit për miratimin e bursave të shkollimit, zbatimi i procedurave të prokurimeve publike.

4.4 Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi sipas sistemeve lidhen kryesisht me mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, parregullsi në procedurat e prokurimit publik, parregullsi në dokumentacionin e detyrueshëm për bursat e studentëve; mangësi proceduriale në mbledhjen e tarifave të shkollimit. Në sistemin e pagesës së pagave e sigurimeve shoqërore, kontabilizimit të veprimeve financiare e raportimit financiar, si dhe menaxhimit të aktiveve, niveli i riskut është i ulët dhe për rrjedhojë gjetjet janë të pakta, për shkak të funksionimit të sistemit informatik të Universitetit të Tiranës, me shumë module në fushën e menaxhimit financiar.

4.5 Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Auditimi i brendshëm në UT ka mundur parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e rasteve abuzive dhe keqmenaxhimit të burimeve financiare, duke ndihmuar menaxherët në rritjen e performancës në Universitetin e Tiranës.

Njësia e Auditimit në UT ka pasur përkrahje të plotë nga Titullari në punën e saj. Shtimi i numrit të auditimeve me natyrë këshilluese do të shërbente në rritjen e kapacitetit profesional të stafit të njësisë të vartësisë në UT.

Në mbështetje të veprimtarisë së auditimit, njësia jonë e auditimit propozon përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me pagesat e vështirësisë në pagë për audituesit e brendshëm, si dhe të planifikohen trajnime më të shpeshta mbi unifikimin e praktikave audituese dhe trajtimin të gjetjeve specifike nga njësi të ndryshme auditimi në mbarë vendin.

5. Rekomandimet

5.1 Rekomandimet e propozuara

Misioni i funksionit të auditimit të brendshëm është dhënia e rekomandimeve të zbatueshme dhe që i shtojnë vlerë subjektit të audituar.

Këto rekomandime i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Janë dhënë rekomandime për përgatitjen e rregullores së brendshme të punës për subjektin e audituar ISE, lidhur me ndarjen e detyrave specifike të punonjësve, me qëllim përmirësimin e proceseve të implementimit të politikave e kuadrit procedural të brendshëm. Për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është dhënë rekomandim zbatimi i procedurave të kontrollit për sistemin e firmosjes së trefishtë të dokumentacionit financiar, si dhe sigurimin e moskryerjes nga i njëjti punonjës të funksioneve që krijojnë konflikt interesi me pozicionin e punës.

Rekomandime të tjera janë dhënë lidhur zbatimin me rigorozitet të legjislacionit mbi bursat e studimit, mbi dhënien me qera të ambienteve të fakulteteve, mbledhjen në kohë dhe rakordimin e të ardhurave nga tarifat e shkollimit, si dhe zbatimin rigoroz të procedurës së prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

5.2 Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit

Rekomandimet e dhëna për subjektet e audituara përgjithësisht janë pranuar nga menaxhimi dhe është kuptuar synimi i rekomandimeve për përmirësimin e dobësive dhe mangësive të gjetura, si dhe për të parandaluar mundësinë e shkeljeve apo abuzimeve. Janë gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxherëve të subjekteve të audituara mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve të lëna nga njësia jonë e auditimit.

Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna ndaj subjekteve të audituara, gjatë vitit 2014 është në proces në muajin janar 2015. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve siguron informacion mbi vlefshmërinë dhe dobishmërinë e auditimeve. Ulja e numrit të shkeljeve të përsëritura dhe nivelit të riskut si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të auditimit është tregues i performancës së lartë të veprimtarisë së njësisë tonë të auditimit në aktivitetet e UT-së.

6. Monitorimi i sistemit dhe sigurimi i cilësisë

Monitorimi i cilësisë së punës së auditit të brendshëm është bërë në përfundim të çdo auditimi, përmes plotësimit të ankëtave standarde për reagimet mbi misionet e auditimit të zhvilluara në njësitë e vartësisë. Sipas vlerësimit të subjekteve të audituara, njësia jonë e auditimit është vlerësuar korrekt sa i përket profesionalizmit, komunikimit gjatë procesit të auditimit, këshillave dhe rekomandimeve mbështetëse ndaj përmirësimit të mjedisit të kontrollit.

7. Analiza e kapaciteteve audituese

7.1 Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB-së

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së NJAB në UT nuk shfaqen problematika lidhur me varësinë strukturore të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Varësia është e drejtpërdrejtë nga Titullari i Ut-së dhe rekomandimet e njësisë janë marrë në konsideratë në përmirësimin e punës në UT. Megjithatë mendojmë se nevojitet mbështetje më e madhe nga menaxhimi në njësitë e audituara, lidhur me sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit. Auditimi duhet të shihet si partneritet për përmirësimin e aktiveteve menaxheriale dhe të njësisë së audituar në tërësi.

7.2 Kapacitetet audituese

Kapaciteti auditues në Universitetin e Tiranës për vitin 2014 ka qenë i plotë, pra nuk ka pasur mungesa në strukturën e ngritur të njësë së auditimit.

Për shkak të plotësimit të strukturës së drejtorisë përmes rritjes së numrit të audituesve të brendshëm gjatë këtij viti (gjithsej 3), numri i angazhimeve të auditimit është rritur krahasuar me vitin 2013.

Audituesit e njësisë së auditimit në UT kanë kryer në kohë trajnimin e organizuar nga Njësia Qëndrore e Harmonizimit, për vitin 2014. Gjatë këtij trajnimi janë arritur objektivat kryesore për përmirësimin dhe zhvillimin e aftësive të stafit të njësisë së auditimit të brendshëm në UT. Trajnimi i

audituesve për vitin 2014 thelloi më tej njohuritë me praktikën e përditësuar dhe profesionale të auditimit.

8. Konkluzione

8.1 Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Puna audituese në Universitetin e Tiranës është reflektuar në përmirësimin e aspekteve menaxheriale dhe aktiviteteve të përditshme në njësitë e vartësisë së Universitetit të Tiranës. Në këtë mënyrë është mundësuar parandalimi, zbulimi dhe ndjekja e rasteve abuzive dhe keqmenaxhimit të burimeve financiare, si një instrument në duart e menaxherëve për rritjen e performancës në Universitetin e Tiranës.

Në mënyrë të vazhdueshme, auditimi është një mekanizëm, i cili siguron Rektorin që fondet publike janë përdorur për qëllimin për të cilin ato janë alokuar dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

8.2 Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për vitin e ardhshëm, prioritet i njësisë tonë të auditimit do të jetë auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm brenda njërive kryesore të UT-së, identifikimi dhe auditimi i fushave të konsideruara me risk më të lartë.

Përmes dhënies së rekomandimeve me natyrë unifikuese në fusha të ndryshme në subjektet e audituara, procesi i auditimit në njësitë e UT-së do të funksionojë si një mekanizëm, që do të sigurojë Rektorin dhe menaxherët e tjerë të Universitetit të Tiranës që fondet publike janë përdorur për qëllimin për të cilin ato janë alokuar dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.